



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/1115**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Anëtar të panelit duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Gerber Architekten International GmbH”, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e ‘Teatrit të Operës dhe Baletit të Kosovës, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës – Ritenderim” me numër të prokurimit 207-24-1140-4-1-3, me 20/01/2025, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e OE “Gerber Architekten International GmbH” me nr. 2024/1115, e datës 15/11/2024, lidhur me vendimin e AK Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK për aktivitetin e prokurimit “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për ndërtimin e ‘Teatrit të Operës dhe Baletit të Kosovës, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës – Ritenderim” me numër të prokurimit 207-24-1140-4-1-3.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se për aktivitetin e prokurimit sipas përshtimit në dispozitivin I të këtij vendimi.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërishtë e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

#### ***-Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 16.02.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë- Konkurs projektimi lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm, të arkitekturës dhe të inxhinierisë, për

ndërtimin e ‘Teatrit të Operës dhe Baletit të Kosovës, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës – Ritenderim” me numër të prokurimit 207-24-1140-4-1-3.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 2,700,000 €.

Njoftimi mbi Vendimin e AK për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për çmimin e parë (1) për GOE BIG Partners Ltd & ALB ARCHITECT, është publikuar datën 31.10.2024.

OE “Gerber Architekten International GmbH” me datën 05.11.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. AK me datën 06.11.2024 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 15.11.2024 operatori “Gerber Architekten International GmbH” ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/1115 (Nr. protokolli).

### **Në fazën e shqyrtimit paraprak:**

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 30.12.2024 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

Ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar,

Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “Gerber Architekten International GmbH”

Përgjigje mbi pretendimin ankimor 1: Kriteri i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues është si vijon: Kërkesa 1.2.: Operatori ekonomik [projektuesi/ Grupi i operatoreve ekonomik-Konsorciumi [projektues], duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure. Për këtë qëllim, Operatori ekonomik [projektues]/ Grupi i operatoreve ekonomik- Konsorciumi [projektues], duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2021,2022 dhe 2023, ka siguruar të ardhura minimale vjetore bruto, në vlerë mbi 4,000,000.00 € dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare- Kërkesa 1.2.: -Raportet financiare, për secilin nga tre (3) vitet fiskale, të certifikuara nga një firmë e licencuar për auditim ose nga një auditor i pavarur i licencuar[Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik-Konsorciumit (projektues), dëshmia duhet të dorëzohet në veçanti për secilin Operator ekonomik (projektues)]:- Një [ 1 ] kopje e origjinalit, e vërtetuar nga noteri.

Pra, nga Autoriteti Kontraktues në Formularin e Dosjes së Tenderit është specifikuar qartë se në rastin kur Operatorët Ekonomik paraqiten si grup Raportet / Dëshmia duhet të dorëzohet në veçanti për secilin Operator Ekonomik. Andaj ju nuk keni arritur të dorëzoni dokumentacionin sipas kërkesës së paraqitur në Dosjen e Tenderit. Po ashtu nga ana e juaj keni specifikuar se e keni dorëzuar raportin e auditimit në gjuhën gjermane (gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, respektivisht me Neni 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik ku specifikohet në piken 4 Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në Gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze). Andaj ju nuk keni arritur të dorëzoni dokumentacionin sipas kërkesës së paraqitur në Dosjen e Tenderit.

Ju jeni eliminuar në përputhje të plotë me Ligjin për prokurim Publik dhe Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik, pika 26.5. ku specifikon: 26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzojë Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Pra, ju nuk e keni dorëzuar gjendjen ekonomike dhe financiare për të gjithë anëtarët e grupit.

Përgjigje mbi pretendimin ankimor 2: Pretendimi ankimor nga ana e Gerber Architekten International GmbH (5641) nuk qëndron për faktin se kjo çështje është e rregulluar me nenin 71 të LPP-së pika 4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Dhe nenin 26.5 të

Rregullores 001/2022. Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtareve individual të grupit. Andaj duke e ditur që me raportet financiare të dorëzuara nga ana e kompanisë plotësohet kriteri si Autoritet duke u bazuar në raportet tjera të dërguara dhe të noterizuara, duke plotësuar shumën financiare kemi konsideruar dhe konsiderojmë se kërkesa nga kompania e shpallur fitues plotëson kriteret në plotni sipas kërkesës nga autoriteti kontraktues. Pra, dallon fakti kur një OE brenda grupit nuk ka dorëzuar fare raporte dhe dallon kur ka dorëzuar (vetëm për 2 vite) dhe ka dorëzuar deklaratë që auditimi behet me data tjera dhe që i plotëson kriteret e vendosura nga ana e autoritetit kontraktues.

Përgjigje mbi pretendimin ankimor 3: Autoriteti Kontraktues Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit askund në asnjërin prej arsyeve të eliminimit nuk ju ka eliminuar për këtë çështje që ju si OE nuk e keni plotësuar mirëpo jeni eliminuar për çështje krejtësisht tjera:

Raporti i auditimit nga Lideri Gerber është në gjuhën gjermane.

Raporti i auditimit i përkthyer nga përkthyesi ligjor është dorëzuar 3 orë pasi ka kaluar afati

Raportet e auditimit sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues nuk janë dorëzuar fare nga anëtari i konzorciumit HARK Architecture.

Andaj shtjellimi i kërkesës nga ana e juaj nuk qëndron si rezultat se ju jeni eliminuar për arsyeje tjera.

Përgjigje mbi pretendimin ankimor 4: Autoriteti Kontraktues Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka paraqitur kërkesë për sqarime shtesë të kompania Gerber Architekten International GmbH (5641) me qëllim që të plotësohet dokumentacioni sipas kërkesës “dokumentacioni është ngarkuar në platformë me datë 16.10.2024 në orarin zyrtar të punës “shiko dokumentacionin e bashkangjitur në formë fotografie”. Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore 1-Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Operatori Ekonomik Gerber Architekten International GmbH (5641) ka paraqitur dokumentacionin në ditë e 5 në ora 19:08 dhe si i tillë dokumentacioni përpos që është dorëzuar pas afatit i njëjti nuk i plotëson kriteret pasi që noterizimi i saj nuk është paraqitur në gjuhën shqipe, angleze ose serbe. Andaj, GOE ka arritur të paraqes dokumentacionin 3 orë e 8 minuta pas afatit kohor dhe se i njëjti nuk ka arritur të paraqes apo plotësoi dokumentacionin brenda afateve kohore sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues. Në këtë formë ju jeni eliminuar dhe se oferta e juaj është ofertë e pa përgjegjshme.

Përgjigje mbi pretendimin ankimor 5: Autoriteti Kontraktues ka respektuar në plotni kërkesën tuaj për sekret afarist dhe kjo shihet qartë në kërkesën e paraqitur nga kompania tani me e shpallur fitues ku specifikon: Pra edhe vet Kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga: GOE BIG

Partners Ltd & ALB ARCHITECT, është pretendim që ne nuk i kemi dhënë dokumentacionin e kompanisë suaj dhe se të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura nga kjo kompani ishin pretendime të supozuara duke aluduar që ju nuk i plotësoni këto kritere. Autoriteti ngjashëm ka vepruar edhe ne rastin e kërkesës suaj për qasje në dokumente zyrtare ku ju ka përgatitur dosjen për qasje vetëm atëherë sa OE ka paraqitur si dokumente që nuk janë sekret afarist.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gerber Architekten International GmbH” në ankesën Nr. 1115/24 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Pretendimet e AK në Njoftimin mbi Vendimin e datës 31.10.2024, për aktivitetin e prokurimit nr.207-24-1140-4-1-3, lidhur me eliminimin janë se “GOE Gerber Architekten International GmbH & HARK architecture” për shkak se “[nuk kanë arritur të paraqesin raportet e audituara të noterizuara sipas kërkesës (pasi që raporti ishte në gjuhën gjermane dhe si i tillë i bie që është jashtë gjuhëve zyrtare që njihen sipas Ligjit të prokurimit publik, konkretisht në kundërshtim me Neni 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik ku specifikohet në pikën 4 Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze)]. Pas kërkesës nga AK, Operatori Ekonomik në fjalë ka paraqitur një raport të gjuhës shqipe por që i njëjti nuk është i noterizuar, ky raport është ngritur në sistem elektronik nga kompania në orën 19:10 tri pas afatit të paraqitur nga AK, po ashtu i njëjti nuk ka paraqitur dokumentin në fjalë në formë fizike siç ishte kërkesa e AK. Në ky kriter kompania tjetër në konsorcium HARK architecture nuk ka arritur të plotësojë kriterin: 1.2-Raportet financiare, për secilin nga tre (3) vitet fiskale, të certifikuar nga një firmë e licencuar për auditim ose nga një auditor i pavarur i licencuar Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik- Konsorciumit (projektues), dëshmia duhet të dorëzohet në veçanti për secilin Operator ekonomik (projektues) (pasi që kompania është hapur në shkurt të vitit 2024). Këto pretendime janë të paqëndrueshme për faktin se: 1.1. Sipas dosjes së tenderit në kuadër të kërkesave mbi gjendjen ekonomike dhe financiare përkatësisht pikën 1.2 të kërkesave për Kapacitetin ekonomik dhe financiar është kërkuar nga Grupi i operatoreve ekonomik – Konsorciumi [projektues], që dëshmojë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2021, 2022 dhe 2023, ka siguruar të ardhura minimale vjetore bruto, në vlerë mbi 4,000,000.00€”. Kurse të dëshmia e kërkuar dokumentare Autoriteti kontraktues ka kërkuar që konsorciumi të dorëzojë “Raportet financiare, për secilin nga tre (3) vitet fiskale, të certifikuar nga një firmë e licencuar për auditim ose nga një auditor i pavarur i licencuar. Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik- Konsorciumit (projektues), dëshmia duhet të dorëzohet në veçanti për secilin Operator ekonomik (projektues)]: Një kopje e origjinalit, e vërtetuar nga noteri.” GOE Gerber Architekten International GmbH & HARK architecture konform ligjit dhe kërkesës së Autoriteti kontraktues ka dërguar Kopjen e origjinalit në gjuhën gjermane të noterizuar të auditimit financiar për tri vitet fiskale. Në realizim të aktiviteteve të prokurimit NR.207-23-3235-5-1-1 Kompania HARK architecture SHP.K. e themeluar në fillim të vitit 2024 është pjesë e konsorciumit GOE Gerber Architekten International GmbH & HARK architect dhe si e tillë nuk obligohet për ta dëshmuar plotësimin e kriterit financiar si e veçantë nga Konsorciumi pjesë e së cilës është në këtë aktivitet prokurimi.

Vlen te theksohet se me datë 23.09.2024, AK vlerësoi për herë të parë projektin si projektin më të mirë dhe më të suksesshëm dhe shpalli fitues konsorciumin GOE Gerber Architekten International GmbH & HARK - architect. Ky vendim u mor në bazë të dokumenteve financiare dhe teknike të paraqitura nga ky konsorcium, të cilat ishin në përputhje me të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në kushte të tenderit. Duke pasur parasysh se konsorciumi ka përmbushur të gjitha kriteret dhe nuk ka pasur asnjë ndryshim në dokumentacionin e paraqitur, eliminimi i tij nga procesi i aktivitetit, më datën 31.10.2024, është plotësisht i paqartë. Ky eliminim krijon një kontradiktë të drejtpërdrejtë me vlerësimin fillestar dhe shpalljen e fituesve nga ana e AK-së.

Në këtë kontekst, mbetet e paqartë dhe e papranueshme pse një autoritet kontraktues që ka shpallur fitues një konsorcium për projektin më të mirë, më pas e ka eliminuar atë pa një arsyetim të qartë dhe pa asnjë ndryshim substancial në dokumentacionin e paraqitur. Kjo ngre dyshime mbi transparencën dhe qëndrueshmërinë e procesit të vlerësimit dhe eliminimit të projekteve.

Pretendimi i dytë (II): Vendimi për eliminimin e GOE nga aktiviteti i prokurimit është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 dhe atë si në vijim: AK ka eliminuar GOE & Gerber Architekten International GmbH & HARK architecture në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin publik që ka të bëjë me Barazinë në Trajtim/Jo-Diskriminimi. AK ne rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me vet LPP neni 7, Rregulloren nr.001/2023, Udhëzuesin 001/2023 dhe vet praktikën e ndërtuar ndër vite nga vet AK - MKRS.

Për ta konfirmuar faktin e trajtimit të pabarabartë dhe diskriminimin tonë, mjafton që të shikohen shkresat e lëndës në tenderin me nr. 207-24-1140-4-1-3 Tenderi: Zhvillimi i projektit ideor dhe të hollësishëm, te arkitekturës dhe te inxhinierisë, për ndërtimin e Teatrit të Operës dhe Baletit të Kosovës, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës - Ritenderim, e zbatuar nga vet AK - MKRS.

Në këtë tender me qellim që të shpallet fitues GOE BIG Partners Ltd & ALB ARCHITECT janë përdorur standarde të ndryshme në rastin e vlerësimit të dokumentacionit në veçanti atij financiar. Konzorciumi fitues në shkresën e dërguar me 5 prill 2024 nga lain Thom, kanë sqaruar se nuk mund të paraqesin dokumentacionin financiar për 3 vite për faktin se viti fiskal mbaron me 30 shtator 2024, kurse në rastin e GOE “Gerber Architekten International GmbH & HARK architecture të njëjtit janë eliminuar për faktin se anëtari i konzorciumit nuk ka pasur mundësi të përmbush kërkesën e njëjtë përkatësisht kushtit financiar të dorëzimit të pasqyrave financiar gjatë 3 viteve të fundit. Mos të harrojmë se e njëjta ka bërë deklaratë të regjistrimit të kompanisë me 29.02.2024 dhe se e njëjta nuk mund të ofrojë raporte financiare të audituara për arsye se raportet e audituara dhe pasqyrat financiare merren në muajin prill të vitit pas, ky dokument është dorëzuar origjinal i nënshkruar dhe vulosur si dhe në 2 kopje në dosjet kopje të konkursit. Prandaj, kjo arsye e AK-se paraqet qasje diskriminuese dhe trajtim jo të barabartë në mes të operatoreve ekonomik e që është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin publik.

Pretendimi i tretë (III): AK ka eliminuar GOE “Gerber Architekten International GmbH & HARK architecture në kundërshtim me nenin 71 lidhur me neni 68 të Ligjit për Prokurimin

publik që ka të bëjë me Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik dhe Gjendja Ekonomike dhe Financiar AK në letrën standarde ka sqaruar se njëra prej arsyeve të eliminimit ka qenë se HARK architecture njëra nga kompanitë në kuadër të Konzorciumit nuk ka arritur të plotësoi kriterin: 1.2-Raportet financiare, për secilin nga tre (3) vitet fiskale, të certifikuara nga një firmë e licencuar për auditim ose nga një auditor i pavarur i licencuar. Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik- Konzorciumit (projektues), dëshmia duhet të dorëzohet në veçanti për secilin Operator ekonomik (projektues) (pasi që kompania është hapur në shkurt të vitit 2024). Nenit 71 par. 4 i LPP përcakton se “Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”. Kurse neni 68 par. 1 përcakton se “Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrijnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur kërkohet, qarkullim minimal vjetor që operatorët ekonomik duhet të kenë nuk do të kalojë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do të referohen maksimum tri viteve të fundit financiare...”. Pra në rastin konkret dëshmia e kërkuar dokumentare në rast të Grupit të operatoreve ekonomik- Konzorciumit (projektues), dëshmia duhet të dorëzohet në veçanti për secilin Operator ekonomik (projektues) dhe elimini i konzorciumit për mos përmbushjen e këtij kriteri nga ana e anëtarit të konzorciumit është në kundërshtim me nenin 71 të LPP-se.

Pretendimi i katërt (IV): AK ka eliminuar GOE “Gerber Architekten International GmbH & HARK- architecture për shkak se raporti i paraqitur i auditimit financiar për 3 vitet fiskale nuk ka qenë i noterizuar. Sipas kërkesës për dëshmi të kërkuar dokumentare AK ka kërkuar që një [1] kopje e origjinalit të auditimit të jetë e vërtetuar nga noteri. Konzorciumi ka paraqitur kopjen e origjinalit të vërtetuar nga noteri e cila është në gjuhën gjermane, kurse pas kërkesës se AK-se Gerber Architekten International GmbH. paraqitur edhe përkthimin e këtij dokumenti. Në dosjen e tenderit askund nuk kërkohet që përkthimi i dokumenteve të jetë i noterizuar, një kërkesë e tillë nuk parashihet as në LPP përkundrazi në nenin 67 të LPP përcaktohet se “KRPP përgatit dhe miraton rregullat lidhur me llojet e dokumenteve, provave dhe/ose deklaratave që operatori ekonomik duhet ti paraqes për të dëshmuar se ai nuk është përjashtuar sipas dispozitave të nenit 65 të këtij ligji. KRPP-ja po ashtu duhet të përgatisë dhe miratojë rregulla për llojet e dokumentacionit që autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga një operator ekonomik për të dëshmuar përshtatshmërinë e tij profesionale sipas nenit 66 të këtij ligji. KRPP-ja duhet të sigurojë që sipas rregullave në fjalë të mos kërkohet rreptësisht paraqitja e dokumenteve ose deklaratave që nuk janë në dispozicion në vende ose rajone të caktuara. KRPP-ja duhet të sigurojë që rregullat në fjalë në masë të arsyeshme të lejojnë operatorëve ekonomik paraqitjen e deklaratave nën betim, deklaratave të noterizuara e të ngjashme. Në të gjitha rastet, nga operatori ekonomik kërkohet që të pranojë mundësinë e sanksionimit të tij penal dhe civil si dhe përgjegjësinë e tij për dënimet dhe dëmet, nëse operatori ekonomik me dashje ose nga pakujdesia

paraqet një dokument, deklaratë ose raport materialisht të pasaktë ose mashtrues”. Pra LPP kërkon që vetëm deklaratat nën betim dhe deklaratat tjera të ngjashme të karakterit tjetër personal të noterizohen por në asnjë rast nuk kërkohet noterizim i dokumenteve zyrtare. AK ka kompetencën e plotë të vërtetimit të saktësisë së dokumenteve dhe në çdo kohe që vërtetohet e kundërta AK ka të drejtën e ndërprerjes së aktivitetit të prokurimit për atë arsye dhe bartjen e përgjegjësisë penale dhe civile të Operatorit ekonomik nëse “paraqet një dokument, deklaratë ose raport materialisht të pasaktë ose mashtrues” siç përcaktohet në nenin 67 të LPP-së. Për më tepër GOE “Gerber Architekten International GmbH & HARK architecture ashtu siç është kërkuar nga AK ka paraqitur kopjen e noterizuar të origjinalit të auditimit financiar për 3 vite, e noterizuar te noteri Catherine Westerwelle me datën e noterizimit 10.04.2024 në Dortmund, Gjermani, kurse është dorëzuar dhe përkthimi nga Haxhi Berisha përkthyesi i licencuar nga RTC Treuhand GmbH & Co, KG |NORDDEUTSCHE AG| 5606128 | 644, e të cilat gjenden në dosjen e tenderit. Kështu që eliminimi i Konzorciumit për shkak se përkthimi është i pa noterizuar është në kundërshtim me vet kërkesën e AK për dorëzimin e kopjes së noterizuar të dokumentit e që në këtë rast është dorëzuar kopja e noterizuar e raportit të auditimit si dhe është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Pretendimi i pestë (V): AK në letrën standarde ka arsyetuar eliminimin e GOE “Gerber Architekten International GmbH & HARK architecture me faktin se Operatori Ekonomik në fjalë ka paraqitur një raport të gjuhës shqipe por që i njëjti nuk është i noterizuar, ky raport është ngritur në sistem elektronik nga kompania në orën 19:10 tri pas afatit të paraqitur nga AK, po ashtu i njëjti nuk ka paraqitur dokumentin në fjalë në formë fizike siç ishte kërkesa e AK. Arsyeja e tillë për eliminimin e konsorciumit është në kundërshtim me Ligjin e procedurës administrative i cili është ligj special (lex specialis) për përcaktimin e afateve në procedurën administrative, procedurë e cila zhvillohet edhe në aktivitetet e prokurimit nga Autoriteti kontraktues. Neni 81 i Ligjit për procedurën administrative përcakton se “1. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, afatet do të përcaktohen në ditë, muaj apo vite. Mbarimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike. 2. Kur afati përcaktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja nga e cila fillon të ecën afati.” Gjithashtu dhe legjislacioni i prokurimit publik të gjitha afatet i përcakton me ditë sikurse edhe AK që ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit brenda 5 ditëve. AK me shkresën e datës 16/10/2024 ka dhënë afat 5 ditor Konzorciumit që të plotësoj dokumentacionin. Kështu që afati 5 ditor ka filluar të rrjedhë prej datës 17/10/2024 e i cili përfundon me datën 21/10/2024 në ora 23:59 kur dhe përfundon dita, për shkak se afati është i përcaktuar me ditë dhe jo me orë. Eliminimi i Konzorciumit me arsyen se ka kaluar 3 ore nga orari i punës përkatësisht se është ngarkuar në sistem në ora 19:10 është në kundërshtim me Ligjin e procedurës administrative dhe Legjislacionin e prokurimit publik. Pra AK ka bërë kërkesë për sqarim nga GOE duke u bazuar në RRUOPP pika 39 në bazë të të cilit AK mund të kërkojë sqarim të dosjes së tenderit dhe në pikën 39.6 thuhet “AK do të caktojë afat kohorë të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre” dhe të njëjtin ligj AK e ka shkelur duke mos respektuar afatin të cilin arsyeshëm e ka caktuar në kërkesën për sqarim të dokumenteve të dosjes së tenderit. Gjithashtu AK ka shpallur fitues GOE BIG Partners Ltd & ALB ARCHITECT me 46.87 pikë për projektin ideor (vendi i



trete ne dizajn) dhe 20 pikë për ofertën financiare, gjithsejte 66.87 pikë. E njëjta ka bere kërkesë për shqyrtim duke u bazuar ne “dyshimet” e tyre qe GOE “Gerber Architekten International GmbH & HARK architecture nuk ka pasur dokumentet ne gjuhen zyrtare te pranueshme ne MKRS pavarësisht se dokumentet e tilla është dashur te jene te mbrojtura ne baze te kërkesës sonë për sekret afarist. Me këtë rast AK ka shkelur RRUOPP pika 7 duke i ofruar qasje operatoreve tjerë ne dokumentet te cilat dokumente kane qene konfidenciale. Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete të biznesit, AK do ti ofroj çdo pale te interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejte dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit. Konsultimi në zyrën e prokurimit, nëse bëhet fjalë për më pak se 20 faqe A4 dhe qasje direkte të formës elektronike do të jenë të lira nga tarifa.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP-ja me datë 11.12.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1115/2024, i cili është dorëzuar me datë 30.12.2024.

Lidhur me pretendimet e OE “Gerber Architekten International GmbH” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1115 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi (I): Pretendimi parë ankimorë sipas ankesës 1152/24 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së një anëtar i konzorciumit nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes për kapacitet ekonomik/financiarë, konkretisht nuk ka ofruar pasqyrat financiare të audituara. OE ankues pretendon se kërkesat për kapacitet ekonomik/financiar duhet te aplikohen ndaj grupit si tërësi, e jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Vlerësimi ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se kjo kërkesë nuk duhet të aplikohet ndaj secilit anëtar të grupit.

Konstatimi (II): Pretendimi dytë ankimorë prape ka të bëjë me kërkesën për kapacitet ekonomik financiar, ku sipas AK-së verizioni shqip nuk është kopje e noterizuar. Pas analizimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se kërkesë e dosjes ka qenë që të ofrohet kopje e noterizuar e raportit të auditimit të pasqyrave financiare, mirëpo vlerësojmë se kjo kërkesë nuk mund të zgjatet/përcillet edhe për përkthimin e dokumentit. OE ka ofruar kopjen e noterizuar të raportit të auditimit, dhe nuk mund të kërkohej tani edhe noterizimi i “përkthimit” të dokumentit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Konstatimi (III): Pretendimi i fundit (dhe kryesor) ka të bëjë me arsyen e eliminimit, ku sipas AK-së OE ankues ka ofruar sqarimin/plotësimin e dokumentit në gjuhë zyrtare jashtë afatit të

përcaktuar nga AK, konkretisht se i njëjti ka ofruar dokumentet e kërkuara ditën e fundit në ora 19:08, ndërsa afati ligjore sipas LPP-së përfundon në ora 16:00. OE pretendon se i njëjti në pajtim me nenin 81 të Ligjit për Procedurë Administrative (sipas të cilit ligj afati ligjorë është deri në fund të ditës) ka ofruar dokumentet brenda afatit ligjor. Pas analizimit të shkresave të lëndës, kemi gjetur se OE ankues, ashtu siç pretendon AK, dokumentin e kërkuar e ka ngarkuar ditën e fundit (ditën e pestë) në ora 19:08. Sqarojmë se procedurat e prokurimit zhvillohen bazuar në Ligjin për Prokurim Publik në fuqi, sipas të cilit ligj afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Në rastin konkret edhe sipas Ligjit për Procedurë Administrative dispozita e parë në Kapitulli III rregullat për afatet Nënkapitulli I- Afatet e veprimeve procedurale për palët, shtyrja dhe rivendosja në afat. Neni 78 Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale 1. Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët (në vijim: “afati procedural”), përcaktohen nga ligji apo akti nënligjor. Në rastin konkret siç potencuam më lart afatet kohore përcaktohen me LPP në fuqi, mirëpo edhe sipas parimit “Lex Specialis” ligji që rregullon një fushë specifike (LPP për Prokurim) e mbizotëron ligjin e përgjithshëm (Ligji për Procedurë Administrative). Konsiderojmë se afati prej 5 ditëve ka qenë kohë arsyeshme dhe mjaftueshme për ofrimin e përkthimit të një dokumenti, në anën tjetër nuk jemi në njohuri për ndonjë mjet juridik apo dispozitë ligjore si kundër argument ndaj vendimit të AK-së sa i përket eliminimit të OE ankues mbi bazën e shkeljes së afatit për plotësim të ofertës. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është i pabazuar dhe se vendimi i AK-së është në pajtim me nenin 5 par.1 të LPP-së.

Konstatimi i (IV): OE ankues pretendon se AK i ka ofruar qasje një OE tjetër në dokumente/ofertë të OE ankues duke përfshirë qasjen në dokumente të deklaruara si sekret afarist. AK në përgjigje deklaron se të njëjtit nuk i kanë dhënë një qasje të tillë OE, ku sipas AK-së kjo dëshmohet edhe përmes kërkesës për rishqyrtim të OE cili konteston ofertën e OE (tani ankues) mbi bazën e “dyshimeve” se i njëjti nuk plotëson kërkesat e caktuara. Nga qasja që kemi në E-Prokurim ne nuk kemi gjetur dëshmi se OE i ka ofruar qasje ndonjë OE në dokumente të deklaruara si sekret afarist, andaj edhe nuk mund të konfirmojmë ose mohojmë një pretendim të tillë ankimor.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaq operatori ekonomik nuk është deklaruar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

#### ***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i anagazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Mbi bazën e të lartcekurave, paneli shqyrtues duke e mbështetur raportin e ekspertizës vlerëson se vendimi i AK-së për dhënie të kontratës, është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, andaj si i tillë i njëjti duhet të mbetet në fuqi. Gjithsesi për shkak se dy pretendimet e para ankimore të OE ankues janë të qëndrueshme, paneli shqyrtues e vlerëson ankesën e OE si pjesërisht të bazuar, por pretendime këto që nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit ti nënshtrohet procedurës së rivlerësimit.

#### ***-Përfundim-***

Bazuar në kompetencat e OSHP-së të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vuri në të tjerat e tjera dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të gjitha palëve të interesuara do të kenë të drejtë të barabartë në procedurat e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet që të diskriminoj ose dëmtoj një person tjetër në proces ose të një personi ose ndërmarrje.

OSHP niset nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon njohurinë e plotë në ushtrimet e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetin e buxhetit. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka qëndruar si në dispozitiv të vendimit të marrë, i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform ndikimit në dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifave ankimore, për ankuesim.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjesërisht të ankesës të OE, vendosi ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4. 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - Gerber Architekten International GmbH**
- Arkivës së OSHP-së: